

VENDIM
Nr. 38, datë 24.1.2024

PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-s "FOCOPS", NË DETIN MESDHE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të 1 (një) anijeje të klasit "Iliria", e përbërë nga 21 (njëzet e një) efektivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s "FOCOPS", në detin Mesdhe.

2. Misioni i anijes është kryerja e patrullimit detar në përbërje të grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, *Standing NATO Maritime Group-2* (SNMG2), në pjesën lindore të Mesdheut, në kuadër të operacionit të NATO-s "FOCOPS", në detin Mesdhe.

3. Komandimi operacional i anijes gjatë periudhës së angazhimit në operacion kryhet nga komandanti i grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, SNMG2. Për çdo rast, anija ruan varësinë në nivelin kombëtar, duke raportuar në mënyrë periodike për mbarëvajtjen e operacionit.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 21 (njëzet e një) ditë, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të anijes në operacion.

5. Ministria e Mbrojtjes përballon shpenzimet për personelin pjesëmarrës në këtë operacion dhe për anijen, për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) ushqim;

ç) sigurimin e anijes;

d) sigurimin e pajisjeve të komunikimit të sigurt me NATO-n;

dh) siguracionin shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

e) siguracionin shëndetësor për ditët e udhëtimit;

ë) transport;

f) mbështetje shëndetësore;

g) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

gj) karburant, lubrifikante;

h) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

i) riparimin e nivelit II, pas kthimit të anijes nga misioni;

j) taksa portuale dhe shërbime portuale;

k) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare gjatë kohës së kryerjes së misionit;

l) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transportimi i personelit të anijes që merr pjesë në mision, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën, për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia, transportimi i individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline përballohen nga pala shqiptare, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe, ku pala tjetër merr përsipër këto shpenzime.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku